



REPUBLIKA E KOSOVES / THE PUBLIC REPUBLIC OF KOSOVO  
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCY AGAINST CORRUPTION

Dep. DPKI  
Nr. Prot. 03-02/3245/16  
Pr. I faq.  
Broj stranica 02  
Nr. pages  
Data Datumi 23.09.2016  
PRISHTINE

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 23.09.2016, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2780/16, për zyrtarin e lartë z. Xhevat Mehmeti, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Novobërdës (Artanës) për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshëm të Konfliktit të interesit.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-2780/16, qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Xhevat Mehmeti, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Novobërdës (Artanës).**

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit apo mos pajtueshmërisë në ushtrim në funksionit publik është vërejtur se zyrtari i lartë z. Xhevat Mehmeti, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Novobërdës (Artanës), figuron si bashkëpronar dhe person i autorizuar në një biznes privatë e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Xhevat Mehmeti, ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së dhe është njoftuar me rastin e iniciuar për situatë të mundshëm të Konfliktit të Interesit, z. Xhevat Mehmeti, është pajtuar dhe është zotuar se brenda afatit do të sjell dëshmitë që është larguar nga funksioni i personit të autorizuar në biznesin privatë .

Me datën 15.09.2016 nga zyrtari i lartë z. Xhevat Mehmeti, kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se në Biznesin me nr.71259498 dhe emër “Nuga Best KOSOVË” SH.P.K. z. Xhevat Mehmeti nuk figuron me si person i autorizuar i këtij biznesi.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë, Xhevat Mehmeti, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Novobërdës (Artanës), duke hequr dorë nga funksioni i personit të autorizuar në biznesin privat janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe mos pajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues )

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

